

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

DEPARTAMENTI: PRODHIMTARI DHE AUTOMATIZIM

Punim i masterit



PUNIM DIPLOMË

Tema e diplomës:

Vlerësimi i sigurisë në punë në industrinë prodhuese në Kosovë

Titulli i temës në anglisht:

Assessment of safety in the manufacturing industry in Kosovo

Mentori:
Prof.dr. Agron Pajaziti

Kandidati:
OBach.Afërdita Kryeziu

Prishtinë: 2019

Përmbajtja:

KAPITULLI 1. HYRJE	4
1.1 Përshkrimi i Problemit.....	4
1.2 Qëllimi i hulumtimit.....	5
1.3 Pyetjet e hulumtimit.....	5
1.4 Hipotezat e Hulumtimit	6
KAPITULLI 2. SIGURIMI I KUSHTEVE PËR SIGURI NË PROCESIN PRODHUES	7
2.1. Definimi i nocionit të sigurisë në punë.....	7
2.2 Parimet e përgjithshme të sigurisë në punë	8
2.3. Korniza Ligjore e sigurisë dhe shëndetit në punë	9
2.3.1 Siguria dhe shëndetit në punë nga këndvështrim i BE-se.....	9
2.3.2 Korniza ligjore mbi sigurinë dhe shëndetin në punë në Kosovë.....	11
2.4 Detyrimet e Punëdhënësit.....	12
2.4.1 Detyrimet e përgjithshme	12
2.4.2 Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë	13
2.4.3 Ndihma e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i të punësuarve, rreziqet serioze dhe të mundshme.....	13
2.4.4 Detyrimet e punëdhënësit për caktimin dhe zbatimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale	14
2.4.5 Vendorsja e shenjave adekuate për Siguri dhe Shëndet në Punë	15
2.4.6 Objektet / ndërtesat	17
2.4.7 Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës	17
2.4.8 Mënyra e mbajtjes së evidencës	18
2.4.9 Dokumenti final i vlerësimit të riskut i punëdhënësit	19
2.4.10 Informimi dhe konsultimi i të punësuarve	20
2.4.11 Trajnimi i të punësuarve	20
2.4.12 Detyrimet e të Punësuarve.....	21
2.4.13 Kontrollimet Mjekësore të të Punësuarve.....	21
2.4.14 Njoftimi për Aksidentet në Punë	21
2.4.15 Obligimet e Punëdhënësit për Mbrojtjen nga Zjarri	22
2.4.15.1 Rregulla tjera specifike të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë	24
2.5 Kushtet dhe mjedisi i punës	25

2.5.1 Elementet tjera të rëndësishëm për ambientin e punës	27
2.6 Karakteristikat e faktorit të sigurisë në procesin e prodhimit	29
2.6.1 Definimi i faktorit të sigurisë	29
2.6.2 Modelet e përdorura nga siguria e sistemit për analizë	30
2.6.3 Vlerësimi i analizës së rrezikut.....	32
2.7. Siguria në industrinë e prodhimit	34
KAPITULLI 3: PLANIFIKIMET RRETH FAKTORËVE TË SIGURISË NË FABRIKAT PRODHUESE.....	35
KAPITULLI 4: SIGURIMI I KUSHTEVE NË SIGURINË MAKSIMALE NË FABRIKAT PRODHUESE TË MËDHA INDUSTRIALE NË KOSOVË.....	37
KAPITULLI 5: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	54
Literatura:	56
Shtojcë: Pyetësi.....	58

KAPITULLI 1 HYRJE

Lidhmëria e sigurisë në punë dhe e sektorit të prodhimit është një teme e cila është diskutuar në vazhdimësi në forume të ndryshme. Sektori i prodhimit është njëri ndër sektorët me të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të një vendi. Në fakt qëndrueshmëria e stabilitetit ekonomik në mase të madhe varet në prodhimin vendor. Por fatkeqësisht është po ashtu një sektor mjaft i rrezikshëm në Kosovë, sepse shpesh ndodh të paraqiten raste qoftë me lëndime apo edhe me fatalitet. Kjo mund të shkaktohet nga masat e këqija të sigurisë në vendin e prodhimit ose mos respektimi i rregulloreve nga punëtorët ose pronarët. Për të plotësuar këtë, edhe pse prodhimi në Kosovë nuk është në vëllim të madhe, megjithatë jemi dëshmitar kur punëtorët ose lëndohen ose edhe vdesin në vendin e punës siç ka pasur raste në Korporatën Energjetike të Kosovës.

1.1 Përshkrimi i Problemit

Siguria dhe shëndeti i punonjësve është konsiderata më e rëndësishme e biznesit të një kompanie. Sipas ligjit të aplikueshëm për siguri dhe shëndet në punë, asnjë punonjës nuk do të detyrohet për të bërë një punë që ata e konsiderojnë të pasigurt.

Dëmtimet mund të kenë pasoja afatgjata për punëtorët. Aksidentet mund të ndikojnë jo vetëm të vetë punëtori, por edhe kompania prodhuese që është përgjegjëse për sigurinë e prodhimit. Është e lidhur me anën e dytë të kësaj çështje dhe kjo është aspekti financiar. Për industrinë e prodhimit, aksidentet dhe pasojat shëndetësore kanë një ndikim të madh financiar. Pra, nëse duam të menaxhojmë me sukses një kompani, ne duhet t'i shmangim këto kosto nga menaxhimi i duhur i sigurisë në vendet e prodhimit.

Një problem tjetër është edhe fakti se edhe pse punëtori mund të merr lëndime të rënda në vendin e punës, për shkak të pa përgjegjësisë së kompanisë dhe sistemit gjyqësor të brishtë, të lënduarit nuk mund të marrin tretmani dhe/apo kompensime duhur dhe të drejtë. Siguria e përsosur e punës duhet të jetë një kërkesë themelore, e respektuar nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e prodhimit. Ruajtja e sigurisë së përsosur të punës duhet të jetë kryesisht për shkak të shumëllojshmërisë së vështirësive në punën dhe kushtet e punës në industrinë e prodhimit. Duhet të respektohen rreziqet individuale të kërcënimit për jetën dhe shëndetin e punëtorëve gjatë përgatitjes dhe ekzekutimit të punëve prodhuese.

Dedikimi i mangët i vëmendjes dhe mjeteve material mund të shkaktojnë që rreziqet mund të rriten për shkak të një përpjekje për të anashkaluar ose mosrespektimin e standardeve për sigurinë e punës në mënyrë që të ruhet rentabiliteti dhe konkurrenca e kompanive të prodhimit. Pra përfitimi është bërë primar dhe siguria në vendin e punës vetëm si element sekondar. Prandaj, ekziston nevoja për të përmirësuar vazhdimisht masat e sigurisë dhe për të vlerësuar rreziqet e përfshira në projektet e prodhimit dhe për të mësuar të aplikojmë njohuri të reja në punën tonë të ardhshme.

1.2 Qëllimi i hulumtimit

Kjo temë synon të adresojë pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit të diskutuara më poshtë, si në seksionin vijues, dhe sqaruar më tej çështjet e ngritura në pjesën e hyrjes se këtij punimi. Hulumtimi ka për qëllim për të identifikuar dhe vlerësuar çështjet e sigurisë me fokus në industrinë e prodhimit në Kosovë, sepse në fund të fundit menaxhimi i procesit prodhues shpëton jetën.

Poashtu, punimi hulumton dhe kupton plotësisht shkallën, natyrën dhe ndikimet e çështjeve të sigurisë në vendin e punës. Ndërmerre një rishikim gjithëpërfshirës të literaturës, për të kuptuar thellësisht çështjen e sigurisë në punë, në mënyrë që të hapë rrugëpërfundimit dhe rekomandimeve potencialisht të qëndrueshme.

Punimi po ashtu synon që t'i hedh njëvështrim standardëve evropiane të sigurisë në vendin e punës në sektorin e prodhimit dhe nxjerrjen e njëvështrimi krahasues në mes të praktikave të Bashkimit Evropian dhe në Kosovë.

1.3 Pyetjet e hulumtimit

Për të arritur qëllimet e hulumtimit, pyetjet që do të përdorë në përfundim janë si në vijim:

1. Si janë ligjet dhe rregulloret e hartuar në BE dhe Kosovë që trajtojnë këtë temë?
2. Si është praktika lidhur me sigurinë në vendin e punës në sektorin e prodhimit në Kosovë?
3. Deri në çfarë mase implemtohen praktikat dhe legjislacioni në fuqi lidhur me sigurinë në vendin e punës në sektorin e prodhimit në Kosovë?
4. Cilat janë aktivitetet që paraqesin rrezikun më të lartë të sigurisë në vendin e punës në sektorin e prodhimit?

1.4 Hipotezat e Hulumtimit

Hipotezat që në përfundim të punimit do të vërtetohen apo hidhen poshtë janë si në vijim:

H1. Dinamizmi i sigurisë në sektorin e prodhimit ndikon në zgjedhjen e strategjisë konkurruese.

H2. Strategjia konkurruese ndikon në strategjinë e prodhimit.

H3. Ofrimi i një ambienti të sigurt në vendin e punës, ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë së prodhimit.

KAPITULLI 2 SIGURIMI I KUSHTEVE PËR SIGURI NË PROCESIN PRODHUES

2.1. Definimi i nocionit të sigurisë në punë

Nocioni i sigurisë në punë në kontest të Kosovës ka bazën në Kushtetutën Kosovës e cila ka hyre në fuqi në muajin prill të vitit 2008. Nga kushtetuta nxjerrën dy nocione në këtë aspekt, e drejta e sigurisë dhe e drejta e punës. Të dy këto të drejtame në detajejanë shtjelluar përmes nxjerrjes së ligjit për siguri dhe shëndet në punë me Nr.04 /L – 161, i cili i obligon ndërmarrjet punuese të organizojnë, zbatojnë dhe përparoj në mbrojtjen në punë.

Në këtë pjesë të definicionit është e rëndësishme të cekën të paktën dy nocione apo përkufizime të theksuar në ligjin për siguri dhe shëndet në punë.

Siguria dhe shëndeti në punë përkufizohet si – pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarave dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punë.

Tjetërnocion i rëndësishëm i sigurisë dhe shëndetit në punë është edhe përcaktimi i rreziqeve që e rrethojnë ambientin e punë. Në këtë kontekst, rrezik nënkupton – “mundësia që të punësuarit t’i shkaktohet plagë, sëmundje ose problem shëndetësor të menjëhershme apo të mëvonshme, si rezultat i ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike dhe biologjike, mjeteve të punës dhe makinerive pa pajisje mbrojtëse dhe të pasigurta për përdorim, mënyrës së gabuar të përdorimit të mjeteve të punës dhe makinerive si dhe mënyrës së gabuar të organizimit të punës”.

Rreziqet në lidhje me sigurinë dhe shëndetin, duhet të paraqiten në vendin e punës, përndryshe nuk hynë në kuadër të fushë veprimit të asnjë industrie prodhuese. Në këtë aspekt, vendi i punës, “përfshijnë të gjitha vendet dhe hapësirat nën mbikëqyrjen direktë dhe indirekte nga punëdhënësit ku të punësuarit duhet të kryejnë aktivitet në punë dhe të qëndrojnë gjatë procesit të punës”.

Në përgjithësi siguria dhe shëndeti në punë është një fushë disiplinore që rregullon dhe adreson parandalimet e rreziqeve për të parandaluar kërcënimet ose dëmtimin e shëndetit të njeriut në procesin e punës. Nuk ka ndonjë definicion që mund t’i përmbledh të gjitha rreziqet e

mundshme, por se në literature mund të gjenden përkufizime të ndryshme nga këndvështrime të ndryshme. Megjithatë, siguria dhe shëndeti në punë është një përmbledhje e të gjitha masave nga punëdhënësi që janë të dizajnuara për të parandaluar shfaqjen e kërcënimeve ose dëmtimit të shëndetit ose humbjes së jetës punëtorët. Masat mund të jenë në formë teknologjike, teknike, ligjore dhe organizative ose masave administrative. Një grup i këtyre masave zakonisht quhet parandalimi i rrezikut.

Në këtë frymë të diskutimit i është qasur edhe ligji i aplikueshëm për siguri dhe shëndet në punë në Kosovë, ku thekson se masat parandaluese përfshinë, “të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të planifikuara në të gjitha proceset e punës në subjektin punues për të evituar dhe minimizuar rreziqeve qëshkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës”.

2.2 Parimet e përgjithshme të sigurisë në punë

Në diskutimin e parimeve të përgjithshme të sigurisë në punë kryesisht i referohet obligimet që janë barrë e punëdhënësit për të siguruar ambient sa më të sigurtë në vendin e punës për të çfarëdo sektori që është, qoftë në sektorin e prodhimit apo edhe të ndërtimitarisë.

Në Kosovë janë të paktën katër parime kryesore që çdo punëdhënësi është i obliguar sipas legjislacionit të aplikueshëm si në vijim:

- ✓ Çdo punëdhënësi është i obliguar dhe bie nën përgjegjësinë e tij për të krijuar kushtet e punës të sigurtë dhe të shëndetshme të gjitha aspektet e punës.
- ✓ Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të të punësuarit në pikëpamje shëndetësore.
- ✓ Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës.
- ✓ Punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.

Pra, në kuadër të përgjegjësisë së tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurtë, udhëzimet e duhura për përdorimin

dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.

Punëdhënësi duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike.

Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

2.3. Korniza Ligjore e sigurisë dhe shëndetit në punë

Nevoja për të përmirësuar kushtet e punës është një shqetësim kolektiv, i nxitur nga të dyja konsideratat humanitare dhe ekonomike. Krijim i më shumë vende të punës dhe cilësi më të mirë është një nga objektivat kryesore të politikës sociale të BE-së e cila është po ashtu synim i Kosovës. Një punë e sigurt dhe mjedis i shëndetshme është një element thelbësor i cilësisë së punës (EUROSTAT).

2.3.1 Siguria dhe shëndetit në punë nga këndvështrim i BE-se

Direktivat e para Evropiane mbi sigurinë dhe shëndetin në punë u miratuan në bazë të dispozitave të përgjithshme mbi harmonizimin e tregut. Kjo ishte për shkak të faktit se deri në mes të viteve 1980, Traktati nuk krijoi kompetenca të qarta legjislative në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë. Më parë, shëndeti dhe siguria në punë u konsideruan si një plotësim për harmonizimin e tregut dhe politikat ekonomike të Komunitetit Ekonomik Evropian. Mbi këtë bazë, për shembull, u miratua Direktiva 77/576 / EEC për harmonizimin e dispozitave kombëtare mbi etiketat e sigurisë në vendin e punës ose Direktiva 78/610 / EEC mbi harmonizimin e kufijve të ekspozimit në vendet e punës (EU-OSHA).

Akti i vetëm evropian (Single European Act) i vitit 1987 ishte një hap i madh përpara në futjen e dispozitave të reja ligjore mbi politikat sociale në Traktat me qëllim të përmirësimit, veçanërisht në mjedisin e punës, në aspektin e sigurisë së punëtorëve dhe mbrojtjes së shëndetit. Duke futur këtë dispozitë në Traktat, rëndësia e kushteve të sigurta të punës është bërë e dukshme.

Veprimi i BE-së në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë e ka bazën e vet ligjore në nenin 153 të Traktatit të BE-së. Veprimi i komunitetit nuk është i kufizuar në legjislacionin. Komisioni ka zgjeruar fushëveprimin e aktiviteteve të tij, në favor të informimit, udhëzimit dhe promovimit të një mjedisi të shëndetshëm pune duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 153 i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian fuqizon Bashkimi Evropian për të miratuar direktiva për sigurinë dhe shëndetin në punë. Korniza e Direktivës, me shtrirjen e saj të gjerë, si dhe direktiva të tjera mbi aspektet specifike të sigurinë dhe shëndetin në punë, janë baza e legjislacionit evropian të shëndetit dhe sigurisë.

Shtetet Anëtare, në interes të mbrojtjes së punëtorëve, mund të miratojnë rregulla më stërkite kur transponojnë direktivat e BE-së në ligjin kombëtar. Kërkesat legjislative për shëndetin dhe sigurinë në punë mund të ndryshojnë nga një shtet anëtar i BE-së në tjetrin.

Korniza e Direktivës Evropiane mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (Direktiva 89/391/EEC), e miratuar në vitin 1989, ka qenë një moment i rëndësishëm në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ajo garanton kërkesat minimale për shëndetin dhe sigurinë në të gjithë Evropën, edhe pse Shtetet Anëtare mund të mbajnë ose të miratojnë masa më të rrepta (EU-OSHA). Elementet thelbësore të kësaj direktive janë:

- Termi “mjedis pune” është përcaktuar në përputhje me Konventën nr. 155 të ONP-së dhe përcakton një qasje moderne që merr parasysh sigurinë teknike si dhe parandalimin e përgjithshëm të dëmeve shëndetësore.
- Qëllimi i Direktivës është të krijojë të njëjtin nivel sigurie dhe shëndetësie mbrojtje për të gjithë punëtorët (me përjashtim të vetëm që janë punëtorë shtëpiakë dhe disa pjesë të shërbimit publik dhe ushtarak).
- Sipas Direktivës, punëdhënësit duhet të marrin masa të duhura preventivë për ta bërë punën më të sigurt dhe më të shëndetshëm.
- Direktiva përcakton parimin e vlerësimit të rrezikut si një element kyç dhe përcakton elementet kryesore të tij (p.sh. identifikimi i rrezikut, pjesëmarrja e punonjësve, zbatimin e masave të përshtatshme me prioritet për të eliminuar rreziqet në burim, dokumentacionin dhe rivlerësimin periodik të rreziqeve në vendin e punës).

- Detyra e re për zbatimin e masave parandaluese implicitisht e thekson rëndësin e formave të reja të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë si pjesë e proceseve të përgjithshme të menaxhimit (EU-OSHA).

Në vazhdim janëselektuar disa nga Direktivat me kryesore të cilëtregullojnë aspekte te ndryshme të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Direktiva 2009/104 / EC - përdorimi i pajisjeve të punës e 16 shtatorit 2009 në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimi i pajisjeve të punës nga punëtorët në punë (Direktiva e dytë individuale brenda kuptimi i Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391 / EEC).

Direktiva 99/92 / EC - rreziqet nga atmosfera shpërthyes e 16 dhjetorit 1999 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe mbrojtja shëndetësore e punëtorëve potencialisht në rrezik nga atmosfera shpërthyes (15 Direktiva individuale brenda kuptimit të Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391 / EEC).

Direktiva 92/58 / EEC - shenjat e sigurisë dhe / ose shëndetësore e 24 qershorit 1992 mbi kërkesat minimale për sigurimin e sigurisë dhe / ose shenjat shëndetësore në punë (nëntë Direktiva Individuale brenda kuptimit të Nenit 16 (1) i Direktivës 89/391 / EEC).

Direktiva 89/656 / EEC - përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale e 30 nëntorit 1989 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për përdorim nga punonjësit e pajisjeve mbrojtëse personale në vendin e punës (Direktiva e tretë individuale brenda kuptimit të Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391 / EEC).

Direktiva 89/654 / EEC - kërkesat e vendit të punës e 30 nëntorit 1989 në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për vendi i punës (direktiva e parë individuale brenda kuptimit të Nenit 16 (1) të Direktiva 89/391 / EEC).

2.3.2 Korniza ligjore mbi sigurinë dhe shëndetin në punë në Kosovë

Siguria dhe Shëndeti në Punë mbetet një fushë relativisht e pazhvilluar në Republikën e Kosovës. Edhe pse legjislacioni i kësaj fushe, në pjesë të madhe është në përputhshmëri me Direktivat e Bashkimit Evropian në baze të kornizës ligjore cekur me larte. Megjithatë, si në shumë fusha të tjera, edhe këtu sfidat hasen në implementim. Ngecjet në implementim të kornizës ligjore nga ana e kompanive, mungesa e vetëdijesimit të punëtorëve mbi rëndësinë e

sigurisë në punë, dhe mos funksionalizimi i Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë janë vetëm disa nga sfidat kryesore të shtjelluara në vijim të këtij dokumenti.¹

Me konkretisht, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është aprovuar në vitin 2013. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. Ky ligj përjashton apo m mire të themi se nuk zbatohet tek sektorët, veprimtaria e të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, si: Forcat e Sigurisë së Kosovës, policia, shërbimi i zjarrfikësve dhe shërbimet për mbrojtje dhe shpëtim.

Përveç ligjit (Nr. 04/L-0161) për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i rëndësishëm është po ashtu Ligji (Nr.04/L-012) për Mbrojtje nga Zjarri, dhe ligje tjera relevante. Ndërsa rregulloret me të rëndësishme në këtë aspekt janë rregullorja, e MPMS nr.03/2014, Nr.05/2014, Nr.04/2016, Nr.02/2014 dhe rregulloret tjera relevante të sigurisë në vendin e punës.

Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë vendos detyrime për personat pronarët, punëdhënësit, punëtorët, furnizuesit, të vetë punësuarit dhe kontraktorët, dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës, për të krijuar dhe mirëmbajë kushtet të sigurisë dhe të shëndetshëm në punë.

2.4 Detyrimet e Punëdhënësit

2.4.1 Detyrimet e përgjithshme

Në kuadër të përgjegjësive të sajë, Punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurte, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës të përshtatshme, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.

Punëdhënësiduhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike.

Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

¹Nida Krasniqi, “Analize e shkurtermbiSigurindheShendetinnëPunë”,

2.4.2 Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë

Punëdhënës i cili punëson mbi pesëdhjetë (50) e më pak se dyqindpesëdhjetë (250) të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspertë, për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë (Neni 10.2 nga ligji).

2.4.3 Ndhimja e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i të punësuarve, rreziqet serioze dhe të mundshme

Punëdhënësi është i detyruar të ndërmarrë masat e nevojshme për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarve, të përshtatura sipas natyrës së aktiviteteve dhe madhësisë së subjekteve punuese.

Punëdhënësi trajnon personat, që do të kryejnë evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së parë.

Punëdhënësi përmes personave të trajnuar, kryen evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së parë, për të punësuarit në subjektin punues.

Përgatitja dhe realizimi i programit për trajnime për të punësuarit për kryerjen e sigurtë të punës duhet të bëhet nga persona profesional (ekspert) në përputhje me Nenin 4 dhe 7 të rregullores nr. 2-2014.

Punëdhënësi harton një plan për evakuimin dhe shpëtimin në situata emergjente, të cilin ia bën të ditur të gjithë të punësuarve, si dhe kryen ushtrime praktike, të paktën një herë në dy (2) vjet, në përputhje me këtë plan.

Punëdhënësi është i detyruar të mbajë kontaktet e nevojshme me shërbime të jashtme, sidomos lidhur me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbime shpëtimi dhe shërbimin e zjarrfikësve. Te gjitha këto kontakte duhet vendosen në planin për evakuim dhe shpëtim në situata emergjente.

Punëdhënësi, në rast të rrezikut të mundshëm dhe serioz për jetën dhe shëndetin e të punësuarve, duhet njoftuar sa më shpejtë të jetë e mundur, t'i informojë për hapat e duhur të gjithë të punësuarit të cilët janë, apo mund të jenë të ekspozuar në rreziqe serioze dhe të mundshme, në mënyrë që të parandalojë ose zvogëlojë rrezikun për jetën dhe shëndetin.

Të punësuarit në rastet kur janë të rrezikuar seriozisht dhe të cilët nuk mund të kontaktojnë menjëherë me eprorin përgjegjës do të veprojnë sipas aftësive të tyre të fituara me trajnime dhe pajisjeve teknike që kanë në dispozicion, për të shmangur pasojat e një rreziku të tillë.

Duke pasur parasysh zhvillimin dinamik të jetës, shpesh ndodh që lëndimet në punë si raste emergjente që janë, është domosdoshme të ofrohet ndihma e shpejt mjekësore brenda dhjetë minutave të artë siç theksohet për shkak të rëndësisë që kanë. Ndhma e parë është një grup i procedurave të cilat ndihmojnë të lënduarit deri në ardhjen e Emergjencës, mjekut apo punonjësve të tjerë të kualifikuar të kujdesit shëndetësor (European College of Kosovo, pjese nga materiali i trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, 2019). Prandaj, ndihma e parë jepet për të shpëtuar jetë, parandalimin e përkeqësimit të gjendjes aktuale, dhe përmirësimin e gjendjes aktuale të të lënduarit.

2.4.4 Detyrimet e punëdhënësit për caktimin dhe zbatimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale

- Miratojë fazën e kërkimit, të projektimit dhe hartimit të planit për përdorimin e pajisjeve të punës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- Përpilojë një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut që përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieniku-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës për veprimtarinë përkatëse.
- Përcaktojë cilësitë dhe përgjegjësitë e të punësuarit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, në përshkrimet e punës, sipas pozicionit përkatës të punës.
- Ndërmerre masat për të siguruar materialet e nevojshme për informimin dhe trajnimin e të punësuarve dhe të vendosë shenja adekuate për siguri, të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Sigurojë informimin e çdo të punësuarit përpara fillimit të punës për rreziqet ndaj të cilave ai mund të ekspozohet në vendin e tij/saj të punës, si dhe për masat e nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse.
- Sigurojë që të punësuarit të jenë të pajisur me kualifikimet përkatëse profesionale.

- Marrë në punë të punësuarin në bazë të ekzaminimit mjekësor të tij, në varësi të vendit të punës.
- Sigurojë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit dhe të njëjtat të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit.
- Mbajë në gjendje të rregullt dhe t'i rimbushë në afate të caktuara të cilat shënohen në tiketën e vendosur në aparat.
- Vendosë në vende të përshtatshme aparatet për fikjen e zjarrit.
- Vendosë hidrantët në vende të dukshme, të përshtatshme dhe duhet të jenë në gjendje të rregullt për përdorim në çdo kohë.
- Të shënojë qartë ndalimin e pirjes së duhanit në vendet e punës dhe në vende publike.
- Punëdhënësi duhet të sigurojë që mjetet e punës dhe pajisjet individuale mbrojtëse (nëse aplikohet), të jenë në gjendje të mirë dhe të rregullt në çdo kohë.
- Mjetet e komandimit të pajisjeve të punës, të cilat ndikojnë mbi sigurinë, duhet të jene qartazi të dukshme si dhe duhet të kenë një sistem komandimi për ndalimin e tyre plotësisht dhe në mënyrë të sigurve. Nëse është e nevojshme duhet të vendosen edhe barriera për parandalim të rrezikut (Shtojca 1 nenin 2, Rregullorja nr.05/2014).
- Ndriçimi dhe temperatura e vendit te punës dhe vendit ku mirëmbahen pajisjet e punës duhet të jete e përshtatshme në përputhje me veprimtarinë dhe kushtet klimatike.
- Mjetet paralajmërues që përdorën në pajisjet e punës, duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme. Pajisjet e punës duhet të kane shenja paralajmërues, të dallueshme për të garantuar sigurinë e të punësuarve.
- Kërkesat minimale për pajisjet e lëvizshme të punës sipas Shtojcës 1, nenin 2 paragrafi 3, Rregullorja nr. 05/2014).

2.4.5 Vendosja e shenjave adekuate për Siguri dhe Shëndet në Punë

Punëdhënësi duhet ti siguroj shenjat e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendet e tyre të punës dhe objektit në përputhje me ligjin 04_L/161, nenin 13, dhe rregulloren MPMS nr. 04/2016.

Në vendosjen e shenjave duhet marr parasysh çdo vlerësim të rrezikut diskutuar më poshtë në këtë procedure. Shenjat e shëndetit dhe sigurisë bartin vetëm mesazhin dhe informata që saktësohen në ligj dhe rregulloren (MPMS)_nr_04_2016.

Duhet vendosen shenjat e përhershme për shenjat e ndalimit, rrezikut dhe detyrimit, vendndodhjes dhe identifikimit të rrugëve të daljes emergjente dhe objekteve të ndihmës së parë.

Vendndodhja dhe identifikimi i pajisjeve për fikjen e zjarrit, duhet të shënohet në mënyrë të përhershme me tabela dhe ngjyrën e kuqe. Po ashtu duhet vendosur shenjat e përhershme aty ku ekziston rreziku me ngjyre të sigurisë.

Shenjat e rastit (të përkohshme) duhet vendosur kurdo që e kërkon rasti (situata) në përputhje me Shtojcën I, nenin 2.2 të rregullores (MPMS)_Nr_04_2016. Shenjat e përkohshëm përfshin shenjat e ndriçimit (Shih Shtojcën VI të rregullores (MPMS)_Nr_04_2016), sinjalet akustike (shih Shtojcën VII të rregullores (MPMS)_Nr_04_2016), komunikimi verbal kur kërkohet (shih Shtojcën VIII të rregullores (MPMS)_Nr_04_2016).

Udhëzimet në Tabelën1 të më poshtme zbatohen për të gjitha shenjat që e përdorin ndonjë ngjyre të sigurisë.

Ngjyra	Domethënia dhe qëllimi	Udhëzimet dhe informacioni
E kuqe	Shenjat e ndalimit	Sjellje e Rrezikshme
	Alarm rreziku	Ndalo! Fik! Pajisje për ndërprerje automatike! Evakuo!
	Pajisje për fikjen e zjarrit	Identifikimi dhe lokacioni
E verdhë	Shenje e Paralajmërimit	Ke kujdes! Merre masa paraprake! Kontrolllo!
E kaltër	Shenje e detyrimit	Sjellje apo veprim specifik; mbani veshur pajisjet mbrojtëse personale
E Gjelbër	Ikje emergjente, shenje e ndihmës se parë	Dyert, daljet, rrugët, pajisjet, objektet
	Nuk ka rrezik	Kthim në normale

Tabela 2.1. Shenja për siguri

Të gjitha shenjat duhet të vendosur në pozicion të përshtatshëm, nuk duhen vendosur shumë afër sa me krijuar paqartësi dhe duhet të mirëmbahen. Numri i shenjave sinjalizuese që duhet

vendosur do të varet nga shkalla e rreziqeve ose zona që duhet të mbulohet. Dimensionet e tabelave dhe veçorit e ngjyrave duhet të kuptohen dhe shihen lehtë.

Shenjat e detyrimit duhet të jenë në përputhje me Shtojcën II, Nenin 3.1; Shenjat e paralajmërimit, Nenin 3.2; Shenjat e detyrimit Nenin 3.3; Shenjat e daljes emergjente ose ndihmës se parë, Nenin 3.4; Shenjat kundër zjarrit neni 3.5² dhe Shtojca IV.

2.4.6 Objektet / ndërtesat

Për çdo objekt / ndërtesë, të destinuar për punë, punëdhënësi duhet të sigurojë:

- ✓ secila ndërtesë t'i ketë daljet emergjente;
- ✓ planin për evakuim në mënyrë që të punësuarit të evakohen nga objekti/ndërtesa, në rastin e ngjarjeve të papritura, prej të cilave rrezikohet jeta dhe shëndeti i tyre;
- ✓ që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të shënuara qartë me shenja adekuate, të cilat do të vendosen në vende të dukshme dhe në përputhje me rregullat;
- ✓ që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të lira, pa pengesa dhe të cilat të dërgojnë direkt jashtë zonës së rrezikshme apo në një zonë të sigurt;
- ✓ hapësirën për dhënien e ndihmës së parë dhe pajisjet e nevojshme;
- ✓ hapësirat ndihmëse, tualetet ndaras për femra dhe meshkuj (nëse është e mundur);

2.4.7 Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës

Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës (nenin 16.1 ligji).

Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës bëhet nga profesionistë të fushave përkatëse brenda subjektit punues të caktuar nga punëdhënësi, përkatësisht nga shërbimet e jashtme ose personat e kontraktuar nga punëdhënësi. (Nenin 16.2 ligji).

Përgatitja e dokumentit për vlerësimin e riskut fillon sipas vendimit të marr nga ana e punëdhënësit për ngritjen e procedurës për vlerësimin e riskut duke përcaktuar **një** ose me shumë

² Çdoherë para porositjes së shenjës duhet konsultuar ky nen dhe nenet tjera për shenja tjera.

persona profesional-ekspertë nga radhët e të punësuarve të cilët janë për zbatueshmëri dhe e procedurës për kryerjen e vlerësimit të riskut (Neni 5.2 (MPMS) 03/2014).

Në përgatitjen e vlerësimit të riskut marrin pjesë personi profesional i ngarkuar nga punëdhënësi, personi juridik i autorizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ushtron shërbime profesionale nga sfera e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mjeku specialist i mjekësisë së punës i autorizuar nga institucioni i autorizuar nga ministria përgjegjëse (Ministria e Shëndetësisë) (neni 5.3 (MPMS) 03/2014).

Punëdhënësi, pas procesit të vlerësimit të rrezikshmërisë, është i detyruar të hartojë dokumentin e vlerësimit të rrezikut dhe të ndërmarrë masat mbrojtëse të domosdoshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve, që përfshinë:

- Mbatja në gjendje të mirë dhe kryerjen e testimeve të kohëpaskohshme (kontrollë periodike) të pajisjeve
- Sigurimi i kushteve të parashikuara për sigurinë dhe shëndetin në ambientin e punës

Mënyra e përgatitjes së dokumentit për vlerësimin e rrezikut, përmbajtja e tij si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut duhet të jete në përputhje me rregulloren “(MPMS) 03/2014 për mënyrën e përgatitjes për vlerësimin e riskut, përmbajtja e tij, të dhënat mbi të cilat duhet të zbatohet vlerësimi i riskut dhe mbajtja e evidencës nga siguria dhe shëndeti në punë”.

2.4.8 Mënyra e mbajtjes së evidencës ³

Punëdhënësi është i detyruar të mbajë evidencën për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisjeve të lënduarin me fletëlëndim në vend të punës.

Për evidencat nga siguria dhe shëndeti në punë, mbahen formularët të cilët janë shtojca e kësaj procedure të adaptuara nga rregullorja. Të dhënat duhet mbahen me dore në një libër të veçantë ose në formë elektronike (Neni 16 (MPMS) 03/2014).

Për mënyrën e mbajtjes së evidencave tjera në punë duhet referuar në mostrat e formularëve të cilët gjenden në rregulloren “(MPMS) 03/2014 për mënyrën e përgatitjes për vlerësimin e riskut,

³Kreu III i rregullores“(MPMS) 03/2014 për mënyrën e përgatitjes për vlerësimin e riskut, përmbajtja e tij, të dhënat mbi të cilat duhet të zbatohet vlerësimi i riskut dhe mbajtja e evidencës nga siguria dhe shëndeti në punë”.

përmbajtja e tije, të dhënat mbi të cilat duhet të zbatohet vlerësimi i riskut dhe mbajtja e evidencës nga siguria dhe shëndeti në punë”.

Evidenca e **vendeve të punës** me risk të rritur mbahen sipas Formularit me nr. 1 (neni 17 (MPMS) 03/2014).

Evidenca për të punësuarit, e në veçanti për të punësuarit që punojnë në vendet e punës me risk të rritur mbahet sipas Formularit me nr. 2 (neni 18 (MPMS) 03/2014).

Evidenca për lëndimet në punë mbahen sipas Formularit nr. 3 (neni 19.1 (MPMS) 03/2014).

Evidenca për sëmundjet profesionale mbahen sipas Formularit nr. 4 (neni 19.2 (MPMS) 03/2014).

Evidenca për punonjësit të aftësuar për punë të sigurtë (para fillimit të punës, dhe personit të cilët e kane ndërruar vendin e punës dhe në rast të ndërrimit të procesit teknologjik të punës) sipas Formularit nr. 5 (Neni 20 (MPMS) 03/2014).

Evidenca e materialeve të rrezikshme (mënyra e shpëtimit, dhënia e ndihmes së parë, pajisjes së shuarjes së zjarrit, ventilimi, hermetizmi, listën e dokumentacionit-pajisjet në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë) të cilat shfrytëzohet gjatë punës mbahen sipas Formularit nr. 6 (Neni 21 (MPMS) 03/2014).

Evidenca e testimëve të ambientit të punës mbahet sipas Formularit nr. 7 (Neni 22 (MPMS) 03/2014).

Evidenca e ekzaminimeve paraprake dhe periodike mjekësore mbahet sipas Formularit nr. 10 (Neni 25 (MPMS) 03/2014).

2.4.9 Dokumenti final i vlerësimit të riskut i punëdhënësit

Pas vlerësimit të riskut nga ana e punëdhënësit nxirret-miratohet, përfundimi, i cili përmban:

- Të dhënat mbi të gjitha vendet e punës që është kryer vlerësimi i riskut,
- Vendet e punës në të cilat është konstatuar risk i rritur – i lartë.
- Prioritetet lidhur me eliminimin e riskut.
- Deklaratën e punëdhënësit me të cilën duhet t'i zbatohet të gjitha masat e përcaktuara për sigurinë në punë dhe ambientin e punës në përputhje me vlerësimin e riskut dhe këto deklarata duhet të ruhen.

Ndryshimi dhe korrigjimi i dokumentit të riskut duhet të bëhet në situatat e parapara në Nenin 14 të rregullores “(MPMS) 03/2014.

2.4.10 Informimi dhe konsultimi i të punësuarve

Punëdhënësi merr masa adekuate që të punësuarit apo përfaqësuesit e tyre të marrin të gjitha informatat e nevojshme lidhur me:

1.1. çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, masat mbrojtëse dhe parandaluese si dhe aktivitetet që i ndërmarrë nga ana e tij për eliminimin e këtyre rreziqeve;

1.2. informimin e të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre për ndihmën e parë, masat në rast zjarri, evakuimin, si dhe përgjegjësitë e veçanta të secilit për marrjen e këtyre masave;

1.3. vlerësimin e rrezikut, si dhe masat e ndërmarra për të siguruar shëndetin dhe mbrojtjen në punë për të punësuarit, gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në gji dhe personat me aftësi të kufizuara.

Punëdhënësi vë në dispozicion të të punësuarve udhëzimet e hollësishme (përfshirë informata adekuate sa u përket shenjave të sigurisë dhe shëndetit), në zbatimin e dokumentit të vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut, për çdo vend pune, i dokumentuar nëpërmjet një procesverbali apo mjeteve tjera të komunikimit.

Punëdhënësi duhet të konsultohet me të punësuarit duke iu mundësuar atyre të marrin pjesë në diskutime lidhur me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë që përfshijnë sipas nenit 19 të Ligjit 04/L-16.

Të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë ankese në përputhje me ligjet e aplikueshme.

2.4.11 Trajnimi i të punësuarve

Punëdhënësi përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë, për vendin e tij të punës si:

para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës;

në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës;

kohë pas kohe nëse është e domosdoshme.

Punëdhënësi ofron trajnim të përshtatshëm për të punësuarit, përfshirë trajnime për çdo risk të mundshëm, nëpërmjet demonstrimeve lidhur me pajisjet e përdorura të punës (Neni 10, Rregullore nr.05/2014).

Trajnimi organizohet gjatë orarit të punës.

2.4.12 Detyrimet e të Punësuarve

Çdo i punësuar ka përgjegjësi të përkujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet dhe të personave të tjerë në punë, në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi.

Në përputhje me trajnimin, udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi, politikat, procedura dhe rregulloret teknike, i punësuarit është i detyruar të:

Përdorë me korrektësi makineritë, aparaturat, veglat, pajisjet e transportit, mjetet tjera për punë dhe të veprojnë me kujdes me substancat e rrezikshme;

Respektojë të gjitha detyrimet e përcaktuara prej punëdhënësit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të kundërtën do të jetë përgjegjës për dëmin ose aksidentin e shkaktuar.

I punësuarit mund të refuzojë urdhëresën për punë, nëse e ka lajmëruar punëdhënësin, personin për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për rrezikun që i kanoset atij/asaj nëse punon në ato kushte të punës, derisa nuk evitohet rreziku dhe nuk krijohen kushtet normale për punë.

2.4.13 Kontrollimet Mjekësore të të Punësuarve

Punëdhënësi është i detyruar t'i dërgojë në kontrollim mjekësor të gjithë të punësuarit së paku një herë në tre (3) vite.

2.4.14 Njoftimi për Aksidentet në Punë

Në rastet kur ka ndodhur aksidenti me pasojë lëndimi apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar ta lajmërojë menjëherë inspektorin e punës.

Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose lidhur me punën kur i punësuarit lëndohet gjatë:

1. kryerjes së punës në subjektin e punës ku është i punësuar;

2. kryerjes së një pune tjetër, pa ose me urdhër të punëdhënësit për arsye madhore në interes të punës;
3. kohës së pushimit të përcaktuar nga punëdhënësi, vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, pastrimit të vendit të punës para ose pas mbarimit të punës;
4. kohës së aftësimin dhe trajnimit profesional;
5. dhënies së ndihmës së parë lidhur me punën.

Punëdhënësi duhet të zbaton dispozitat tjera të Nenit 23 të Ligjit 04/L-16 nëse lind nevoja.

Gjobat aplikohen sipas nenit 25 të Ligjit 04/L-16.

Është e rëndësishme që niveli i ulët i sigurisë në punë ka bërë që gjatë vitit 2018 deri në muajin shtator në Kosovë kanë humbur jetën 22 punëtor, kryesisht në fushën e ndërtimit dhe në fusha tjera, ndërkaq 112 të tjerë janë lënduar. Megjithatë, numri i punëtoreve të lënduar mund të jetë edhe më i madh, pasi jo gjithmonë pronarët e kompanive i paraqesin rastet e lëndimeve, përkatësisht nuk e respektojnë kërkesën ligjore për të njoftuar aksidentet (European College of Kosovo, pjese nga materiali i trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, 2019).

2.4.15 Obligimet e Punëdhënësit për Mbrojtjen nga Zjarri

Punëdhënësi obligohet që në përputhje me Nenit 9 të ligjit për mbrojtjen nga zjarri në procedurën e saj të brendshme të përcaktojnë masat dhe veprimet në lidhje me zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri. Kjo duhet të behet përmes hartimit të Planit për Mbrojtje nga Zjarri.

Punët e mbrojtjes nga zjarri, duhet kryhen nga personat të cilët kanë të kryer trajnimet profesionale për zjarrfikës apo drejtimit teknik, dhe të cilët e kanë të dhënë provimin profesional për kryerjen e punëve për mbrojtje nga zjarri (Nenin 8.4).

Dëshmia për gjendjen e rregullt të pajisjeve. Mirëmbajtja e pajisjeve stabile të destinuara për paralajmërimin dhe fikjen e zjarrit, detektimin e gazrave dhe avujve të ndezshëm si dhe pajisjet tjera mbrojtëse dhe instalimeve të cilat shërbejnë për evitimin e shkaktimit dhe zgjerimin e zjarrit dhe shpërthimit, kryesi i punëve është i detyruar të siguroj dëshminë nga prodhuesi për funksionim të rregullt të tyre, dhe procesverbalin mbi verifikimet e kryera nga personi juridik i autorizua.

Mirëmbajtja e pajisjeve stabile duhet të kontrollohet të paktën një (1) herë në vit nga personat e autorizuar, në varshmëri me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve. Me rastin e kontrollimit mbahet procesverbal në të cilën shënohet se kur është bërë kontrollimi, kush e ka kryer dhe çfarë është vërtetuar nga kontrolli.

Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve punëdhënësit, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, obligimet e përcaktuara si në paragrafin 1. dhe 2. Nenin 16, të ligjit për mbrojtjen nga zjarri rregullojnë me marrëveshje përmes kontratës, në pajtim me ligjet në fuqi.

Kontrolli i pajisjeve të punës që varen nga kushtet e instalimit janë të rregulluara përmes kontratës mbi qiranë e lokaleve afariste⁴ dhe përgjegjësia bije tek pala që e bënë instalimin.

Pronarët e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, janë të obliguar të mirëmbajnë në gjendje të rregullt pajisjet, instalimet, ventilimet e gazrave, oxhaqet si dhe pajisjet e tjera, të cilat paraqesin rrezik për zgjerimin e zjarrit në harmoni me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve për të cilat duhet të ketë dokumentacion (nenin 16.2).

Në qoftë se nuk mund të vërtetohet pronari i objektit, obligimet e përcaktuara i bien në barrë shfrytëzuesit.

Furnizimi me stabilimenteve dhe mjeteve të dedikuara për fikje të zjarrit, lajmërim dhe pengim të zgjerimit të zjarrit si dhe pajisjeve të tjera mbrojtëse e instalimeve, duhet të bëhet nga furnizuesi i cili posedon **certifikata valide** të lëshuar nga autoritetet kompetente.

Pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikjen e zjarrit

Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, obligohen të posedojnë pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikjen e zjarrit.

Pajisjet dhe mjetet për fikje të zjarrit duhet të shfrytëzohen vetëm sipas dedikimit, dhe të jenë në gjendje të rregullt, posaçërisht të shënuar dhe të kapshme për përdorim.

Aparatet bartëse dhe lëvizëse për shuarjen e zjarreve duhet të kontrollohen çdo gjashtë (6) muaj.

⁴Nenin 16.3 Ligji 04_L-012_Ligji për mbrojtje nga Zjarri dhe Rregullorja (MPMS)nr.5_2014, neni 6.

Kontrollimin e rregullsisë dhe servisimit të aparateve mund ta ushtrojnë personat e autorizuar, të cilët janë teknikisht dhe profesionalisht të aftësuar, në bazë të autorizimeve të Ministrisë-Agjencisë.

Personat të cilët kryejnë mbikëqyrjen e rregullsisë dhe servisimit të aparateve nga duhet ta kenë të dhënë provimin profesional për kryerjen e këtyre punëve.

Kur diskutohet për mjetet dhe stabilimentet për fikjen ezjarrit, duhet të dihen se produktet e zjarrit janë drita, nxehtësia deri në 1000celsius, tymi, CO₂, CO, dhe gazrat toksike (helmuese). (European College of Kosovo, pjese nga materiali i trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, 2019).

Mjetet e dedikimit dhe sinjalizimit të zjarrit janë: paneli i detektorëve të zjarrit, detektor tymi i cili jep sinjalin në panelin e alarmit të zjarrit, dhe butoni alarm-zjarri.

Si behet evakuimi nga zjarri? Rreziku i humbjes se jetës gjate një zjarri në shumicën e rasteve nuk është nga kontakti direkt me zjarrin, por nga thithja e tymit, gazrave toksike dhe ekspozimi ndaj temperaturave te larta pasi: reduktohet ose bllokohetplotësisht shikimi, irritohen rrugët e frymarrjes nga thithja e substancave toksike, simulohet frymarrja e shpejte nga thithja e substancave toksike, stimulohetfrymëmarrja e shpejte si rezultat i prezencës nëajër të monoksidit të karbonit, rritet me 50% ritmi i frymëmarrjes duke rritur me 50% dhe thithjen e substancave te dëmshme, dhe rritet shume temperatura duke krijuar kështu situata fatale përjetën(Evropian College of Kosovo, pjese nga materiali i trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, 2019).

2.4.15.1 Rregulla tjera specifike të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

- Respektojë dhe praktikojë procedurat e përcaktuara për siguri dhe shëndet në punë.
- Nëse vëreni ndonjë situatë të mundshme të rrezikshme të raportohet tek mbikëqyrësit tuaj menjëherë.
- Në rast të sëmundjes ose lëndimit, pa marrë parasysh sa e vogël, raportohet në të njëjtën kohë tek mbikëqyrësi juaj. Në rast të ndonjë aksidenti që rezulton në një dëmtim të rëndë, punonjësi më i afërte në momentin e ndodhjes njofton kujdesin mjekësor dhe policinë menjëherë.
- Asnjëherë mos pengoni punonjësin tjetër, sepse ju mund ti shkaktoni atij / asaj që të lëndohet. Nëse është e nevojshme për të marrë vëmendjen e një punonjësi tjetër, prisni

derisa kjo mund të bëhet në mënyrë të sigurve.

- Kur kërkohet, ju duhet të përdorni pajisjet mbrojtëse, të tilla si syze, syze e sigurisë, maska, doreza, rrjeta e flokëve, etj.
- Mos përdorni makina ose pajisje deri sa ju të udhëzoheni si duhet dhe të jeni të autorizuar të veproni kështu nga mbikëqyrësi juaj.
- Mbylle / fike pajisjen tuaj para se të pastroni, riparoni, ose dilni nga vendi i punës përveç nëse është e domosdoshme ndryshe.
- Mbani sipërfaqen tuaj të punës të pastër.
- Merrni pushime të shkurtra nëse është e nevojshme për shëndetin tuaj.
- Respektoni rregullat e duhanit.
- Mos e blloko qasjen në aparatet kundër zjarrit.
- Merrni qëndrim sipas standardeve të aplikueshme para kompjuterit (duke mos qëndruar shumë afër dhe shume gjate pa ndërprerje para kompjuterit).
- Mos u angazhoni në praktika që mund të jenë në kundërshtim me rregullat e zakonshme dhe të arsyeshme të sigurisë dhe shëndetin në punë.
- Rrugëdaljet rezerve të mbahen të lira. Në rast zjarri edhe pengesat fare të vogla për shkak të tymit mund të sjellin vdekjen.
- Mos bllokoni asnjëherë daljet emergjente.
- Në rast se vëreni një person që e ka kapluar zjarri, veprimet e para që duhet ti bëni janë që të vendoset menjëherë në uji pjesa e trupit që digjet. I mblidhet trupi me një rrobë apo material tjetërpër ta izoluar pjesën e trupit që digjet nga oksigjeni i ajarit.

2.5 Kushtet dhe mjedisi i punës

Kushtet në mjedisin e punës, në vetvete, mund të jenë të natyrës së kushteve fizike në punë, klimës sociale dhe psikologjike. Kushtet normale në punë rezultojnë në një mjedis lehtësues dhe të sigurt, të cilat i tërheqin punonjësit për të kënaqur nevojat e tyre, pasi vetëm një mjedis

lehtësues dhe i përshtatshëm në punë rrit nivelin e përkushtimit dhe produktivitetin e punonjësve. Sipas autorëve Moos dhe Billings (1991) kushtet e mjedisit të punës i përkufizuan si karakteristikat socio-psikologjike të ambientit të punës, respektivisht, qëndrimet e punonjësve ndaj detyrave të punës dhe komunikimin ndërpersonal. James (James dhe Ashe, 1990) u përpoqën që mjedisin e punës ta përcaktojnë më tepër në aspektin psikologjik, përmes vlerësimit dhe njohjes së mjedisit organizativ nga punonjësi, duke ndihmuar ata të vlerësojnë rëndësinë dhe kuptimin e mjedisit të punës.

Kushtet dhe mjedisi i punëspërfshinë tëpaktën tri komponentë esenciale të cilat sqarohen në diskutimin në vijim.

Shmangia e rrezikut- sepse rreziku është gjendja e cila në të ardhmen mund të sjellë deri te ndodhia me pasoja të padëshirueshme. Ashtu si aktivizimi i një rreziku mund të rezultojë në një aksident, rreziku lidhet me probabilitetin që frekuenca, intensiteti dhe kohëzgjatja e stimuli do të jetë i mjaftueshëm për të transferuar rrezikun nga një gjendje potenciale në një humbje. Rreziku është term më i gjerë sesa dështimi, ai përfshin mundësinë e humbjes ose dëmtimit. Dështimi mund të ndodh me humbje ose pa humbje, është rasti kur diçka funksionon në një mënyrë jo të planifikuar. Kurse nocioni rrezik përfshinë dy vlerësime:

Gjasa e paraqitjes së një gjendje të padëshiruar.

Pasojat që rrjedhin nga ngjarjet e padëshiruara në raport me shfrytëzuesin dhe mjedisin rrethues të punës.

Shmangia e aksidenteve- sepse aksidentet mund të jenë shkaktimi i një zjarri, shpërthimi, lëshimi i energjisë së lartë, dëmtimi i njëpunëtori në vendin e punës. Ne duhet të përqendrohemi në grupin e ngjarjeve që ndodhin dhe që të çojnë në aksident, duke rezultuar në një humbje. Kështu, aksidenti mund të përkufizohet si një mekanizëm dinamik që fillon me aktivizimin e një rreziku dhe rrjedh përmes sistemit si një seri ngjarjesh, në një mënyrë logjike, për të prodhuar një humbje. Një deklaratë e thjeshtë nga një këndvështrim tjetër është se një aksident është një ngjarje e padëshiruar dhe e paplanifikuar që rezulton me vdekje, lëndim ose dëmtim të pronës. Një incident lidhet ngushtë me një përkufizim të një ngjarje ose ngjarjeje të paparashikuar që nuk rezulton me vdekje, lëndim ose dëmtim të pronës.

Informimi i punëtorëve-Informimi i të punësuarve lidhur me sigurinë gjatë kryerjes së punëve bëhet përmes njoftimeve dhe udhëzimeve me shkrim. Në raste të jashtëzakonshme kur të punësuarit u ekspozohen rrezikut të drejtpërdrejt mbi shëndetin ose jetën e tyre, njoftimet dhe udhëzimet e këtilla mund t'u barten edhe në mënyrë verbale dhe në të njëjtat do të përfshihen të gjitha masat e ndërmarra në lidhje me sigurinë në punë në rast të rrezikut të drejtpërdrejt, serioz dhe të pashmangshëm, punëdhënësi medoemos duhet që të punësuarve tu jap udhëzime përkatëse për ndërprerjen e punës, largimin e shpejtë nga vendi i punës dhe evakuim në ambiente të sigurta. Derisa zgjatë rreziku punëdhënësi nuk guxon t'i angazhojë të punësuarit të kryejnë detyra pune.

Kur një ose më shumë të punësuar janë larguar nga vendi i punës ose nga zona e rrezikshme, për shkak të rreziqeve të drejtpërdrejta ose të pashmangshme mbi sigurinë e tyre në punë, ata nuk mund të merren në përgjegjësi për shkak të reagimit të tyre në situata të këtilla. Punëdhënësi duhet të sigurojë që të gjithë punëtorët gjatë rrezikut serioz ose të drejtpërdrejt mbi sigurinë e tyre ose mbi sigurinë e personave të tjerë edhe në rastet kur nuk mund të kontaktohet me personin profesionist, të ndërmarrin masa përkatëse në kuadër të njohurive të tyre dhe mjeteve teknike të cilat i kanë në dispozicion për t'iu shmangur pasojave nga rreziqet e këtilla. Veprimi i këtillë nuk guxon t'i shpie në një situatë që të merren në përgjegjësi, përveç nëse kanë vepruar në mënyrë të pakujdesshme dhe të pandërgjegjshme.

Punëdhënësi medoemos duhet t'i informojë të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre për çdo lloj rreziku në vendin e punës, si dhe për masat e sigurisë të nevojshme për kontrollin mbi rreziqet dhe eliminimin e pasojave të dëmshme. Punëdhënësi medoemos duhet t'i informojë edhe të punësuarit me kontratë për punë me kohë të caktuar, të punësuarit e rinj, të punësuarit më të moshuar në përputhje me Ligjin për marrëdhënie pune, si dhe ata me aftësi të kufizuar pune në lidhje me rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe për masat e ndërmarra nga ana e punëdhënësit, me qëllim të sigurimit të sigurisë dhe shëndetit të tyre në punë.

2.5.1 Elementet tjera të rëndësishëm për ambientin e punës

Rregulloret janë kërkesa që dalin nga ligji dhe janë po ashtu shumë të rëndësishme. Ndër rregulloret me rëndësi të veçantë henderkërkesat me tërëndësishme është edhe përgatitja e Dokumenteve për Vlerësimin e Riskut, detajet mbi të cilat janë specifikuar në Rregulloren Nr.

03/2014 për Mënyrën e Përgatitjes së Dokumentit për Vlerësimin e Riskut⁵, Përmbajtja e Tij, të Dhënave mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i riskut dhe mbajtja e evidencës nga siguria dhe shëndeti në punë. Kërkesat e kësaj rregullore janë të aplikueshme si tek personat fizik po ashtu edhe te personat juridik të cilët merren me këtë fushë.

Vlerësimi i rrezikshmërisë që duhet punëdhënësi të ketë në mendje ka kuptimin e njëjtte me vlerësimin e riskut që është një procedure e cila përcakton nivelin e rrezikut në lidhje me një lëndim në punë, sëmundje profesionale, sëmundje të lidhura me punën dhe çrregullime të lidhura në procesin e punës që mund të shkaktojnë efekte të dëmshme tek shëndeti dhe siguri e punonjësve.

Vlerësimi i rrezikut bazohet në evidentimin sistematik dhe vlerësimin e të gjithëfaktorëve të procesit të punës, në mënyrë që të përcaktojnë llojet e rreziqeve dhe rreziqeve në vendin e punës dhe ambientin të punës që mund të shkaktojnë dëmtime të shëndetit, lëndime në punë, sëmundje profesionale dhe sëmundje të lidhura me punën. Ndërsa, faktori i riskut i referohet një cilësie të një substance ose mjedisi, që është në gjendje të shkaktojë ndikim negativ për shëndetin e punonjësve të ekspozuar.

Kur flitet për vlerësimin e riskut në punë është e rëndësishme po ashtu të realizohet sipas mënyrës së duhur të vlerësimit të riskut. Vlerësimi i riskut bazohet në analizën e probabilitetit të shfaqur dhe shkallë e lëndimit të mundshëm në punë, dëmtimit të shëndetit ose sëmundjes së të punësuarit lidhur me punën në vendin e punës dhe ambientin e punës.

Vlerësimi i riskut kryhet me zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme, duke u bazuar në rreziqet të përshtatshme, duke u bazuar në rreziqet dhe dëmtimet e njohura dhe të përcaktuara në listën e rreziqeve dhe dëmtimeve në ambientin e punës dhe në çdo vend të punës.

Sigurimi i Kërkesave minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës është element i rëndësishëm për të punësuarit. Për këtë Qeveria e Kosovës ka nxjerrë rregullore të veçanta,⁶ me qëllim që të harmonizojë disa nga kërkesat e ligjit përkatës me Direktivën e BE-së Nr. 89/654/KEE. Sipas kësaj rregulloreje, punëdhënësi ka për detyrë të sigurojë se: (1) rrugët për dalje emergjente janë të lira gjithmonë; (2) mjetet teknike të punës janë të mirëmbajtura; (3)

⁵Rregullorja Nr. 03/2014 për Mënyrën e Përgatitjes së Dokumentit për Vlerësimin e Riskut

⁶Rregullorja Nr. 04/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës

pajisjet janë të sigurta dhe eliminojnë/parandalojnë rreziqet; si dhe (4) ambienti dhe mjetet e punës janë të pastra në çdo kohë. Në Aneksat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje listohen në detaje kërkesat për secilën çështje teknike në vendin e punës.

Ngjashëm, edhe Rregullorja Nr. 05/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Përdorimin e Pajisjeve të Punës në Vendin e Punës, ka harmonizuar kërkesat e ligjit mbi sigurinë e pajisjeve të punës me Direktivën 2009/104/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.⁷

Pra, kjo rregullore, liston kërkesat esenciale që duhet të kenë secila pajisje personale mbrojtëse, në lidhje me mbrojtjen e kokës, mbrojtjen e dëgjimit, mbrojtjen e syve dhe fytyrës, mbrojtjen e frymëmarrjes, mbrojtja e duarve dhe krahëve, mbrojtja e shputave të dorës dhe këmbëve, mbrojtja e lëkurës, mbrojtja e trungut dhe barkut, mbrojtja respiratorë, litarët e sigurisë, dhe mbrojtja e gjithë trupit.

2.6 Karakteristikat e faktorit të sigurisë në procesin e prodhimit

Faktori i sigurisë është një term që përshkruan kapacitetin strukturor të sistemit që të përballojë presionet aktuale apo presionet potenciale të pritura në të ardhmen. Esencialisht, sa më i fortë është sistemi sesa ai në të vërtetë duhet të jetë për një fluks peshe të planifikuar. Faktorët e sigurisë shpesh janë kalkuluar duke përdorur analiza të detajuara sepse testimi gjithëpërfshirës është jo praktik në shumë projekte, sikurse urat dhe ndërtesat, por kapacitete rezistuese të strukturave për të bartur dhe përballuar një presion duhet të përcaktohen më precizitet të matur dhe të vlerësuar mirë. Shumë sisteme janë ndërtuar me qëllime shumë më të sofistikuara dhe rezistence sesa kanë nevojë për përdorimin në gjendje normale për të bërë të mundshëm funksionimin në situata emergjente, flukse të papritura, nga mospërdorimi profesional apo degradimi natyror.

2.6.1 Definimi i faktorit të sigurisë

Ekzistojnë të paktën dy definicione të qarat në lidhje me definimin e faktorit të sigurisë në procesin e prodhimit. Definimi i parë definohet si raport i fuqisë rezistente absolute (kapaciteti strukturor) për përballimin e presionit aktual, kjo është masë e besueshmërisë se një konstruksioni të caktuar. Përdorimi tjetër i nocionit faktori i sigurisë është një vlerë e

⁷Rregullorja Nr. 05/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Përdorimin e Pajisjeve të Punës në Vendin e Punës.

qëndrueshme e përcaktuar nga ligji, standardi, specifikat, kontrata apo porosia kundrejt të cilave një strukture duhet të jetë konforme apo edhe t'i kalojë standardet e parapara.

Përdorimi i parë (standardet e përlogaritura) në përgjithësi i referohet si faktor i sigurisë ose thëne në mënyre më eksplicite (të detajuar), një faktor i përmbushur i sigurisë. Përdorimi i dytë (një vlerë e kërkuar në bazë të standardeve) si faktori i konstruksionit, faktori i konstruksionit të sigurisë apo faktori i kërkuar i sigurisë. Megjithatë qasjet e përdorimit të strukturave të caktuara nga pikëpamja e industrive të ndryshme dhe grupeve inxhinierive nuk janë gjithmonë në koherencë dhe shkaktojnë konfuzitet.

Është më rëndësi të jemi të vetëdijshëm së cilat definicione do të përdorën. Shkaku i kaq shumë konfuzitetëve është se merren referenca nga literaturë e llojllojshme dhe agjenci të ndryshme të standardeve sesi e përdorin definicionin e faktorit të sigurisë dhe terminologjisë në mënyrë të ndryshme. Kodet e konstruksioneve dhe tekstet shkencore të inxhinierisë mekanike dhe strukture shpesh e përdorin “faktorin e sigurisë” për të nënkuptuar pjesët përbërëse të një kapaciteti tërësor strukturor që kërkohet. Shumë tekste të fortësia e materialeve për studentët e studimeve themelore e përdorin “Faktorin e Sigurisë” si vlerë konstante e paraparë si vlerë e standardeve minimale për konstruksion.

2.6.2 Modelet e përdorura nga siguria e sistemit për analizë⁸

Programi AMS i sigurisë së sistemit përdorë modele për të përshkruar një sistem në studim. Këto modele janë të njohur si modeli 5M dhe modeli SHELL. Ndërsa ka shumë modele të tjera në dispozicion, këto të dyja njohin marrëdhëniet dhe integrimin; hardware, software, njeriut, mjedisit dhe procedurat e natyrshme në sistemet FAA. Politika FAA dhe qasja e sistemit të sigurisë është për të identifikuar dhe kontrolluar rreziqet që lidhen me çdo element të një sistemi në një nivel individual. Hapi i parë në kryerjen e menaxhimit të rrezikut të sigurisë është e përshkruar në shqyrtim e sistemin.

Përshkrimi duhet të përfshijë minimalisht, funksionet, karakteristikat e përgjithshme fizike, dhe operacionet e sistemit. Normalisht përshkrimet e hollësishme fizike nuk janë të nevojshme vetëm nëse analiza e sigurisë është fokusuar në këtë zonë. Arsyeja për kryerjen e analizave të

⁸Burim Zogu Punim Masteri, 2016.

sigurisë është për të identifikuar rreziqet për audiencën. Në minimum, vlerësimi i sigurisë duhet të përshkruajë sistemin në detaje të mjaftueshme që mund të kuptoni rreziqet e sigurisë.

Një përshkrim për sistemin i cili ka si gjerësi dhe thellësi. Gjerësia e një përshkrimi sistemi i referohet sistemit kufij. Në përgjithësi, niveli i detajeve në përshkrimin ndryshon anasjelltas me gjerësinë e sistemit. Për një sistem të gjerë të Sistemit Kombëtar të Hapësirës Ajrore (NASA) përshkrimi i ynë do të jetë shumë i përgjithshme në natyrë me pak detaje të komponenteve individuale.

Grafikisht, kjo është e përfaqësuar nga 5 milion dhe SHELL modele, të cilat e përshkruajnë, në përgjithësi llojet e elementeve që duhet të konsiderohen në shumicën e sistemeve.

Modeli 5M i inxhinierisë së sistemit:

- Misioni MSN: qëndror qëllimi apo funksionet
- Njeriu - elementi njerëzor
- Mach - Machine: pajisje dhe sigurim programesh
- Media - Mjedisi: ambienti dhe mjedisi operacional
- Menaxhimi Mgt-: procedurat, linjë veprimidhe rregulloret




Fig.2.1 Modeli pesë-M


Modeli SHELL(skelet)i një sistemi

Fig.2.2 Modeli SHELL

S - Software (procedurat, veprimet, etj.)

H - Hardware (makinë)

E - Mjedisi (operacional dhe ambienti)

L - Liveware (elementi njerëzor)

Në modelin SHELL, ndeshja ose mospërputhja e blloqeve (Interface) është po aq e rëndësishme sa karakteristikat e përshkruara nga vetë blloqet. Këto blloqe mund të ri-organizohet siç kërkohet për të përshkruajnë sistemin. Një lidhje mes blloqeve tregon një ndërfaqe në mes të dy elementeve.

2.6.3 Vlerësimi i analizës se rrezikut⁹

Në kryerjen e analizave të rrezikut, një skenar aksidenti siç është paraqitur në Figurën 2.3 është një model i dobishëm për të analizuar rrezikun e dëmit për shkak të rreziqeve. Gjatë gjithë këtij doracaku të sigurisë së sistemit, termi rrezik do të përdoret për që të përshkruaj skenarë që mund të shkaktojnë dëme. Ajo është e përcaktuar në FAA Rendit 80404 si një kusht, ngjarje, ose rrethanë që mund të çojë në një ngjarje të paplanifikuara ose të padëshiruara. Rrallë ka një rrezik të vetëm të shkaktojë një aksident. Siç shihet në Figurën 2.3,

⁹Burim Zogu Temë Masteri, 2016.

rreziqet kontribuuese përfshijnë faktorin e sistemit të gjendjes (p.sh., mjedisit operativ), si dhe dështimet ose mosfunksionimin.




Fig. 2.3. Mënyra e plan veprimit të rrezikut

(Programi i Sistemit të Sigurisë Kërkesat) përcaktojnë një sistem si:

Grafikisht, kjo është e përfaqësuar nga 5 milion dhe Shel modeli, të cilat e përshkruajnë, në përgjithësi, llojet e elementeve që duhet të konsiderohen në shumicën e sistemeve.

Modeli 5M i inxhinierisë së Sistemit:

Misioni MSN:- qendrore

Qëllimi apo funksionet

- Njeriu - element njerëzor
- Mach - Machine: hardware dhe software
- Media - Mjedisi: ambientit dhe operacional mjedisi
- Menaxhimi MGT: procedurat, politikat dhe rregulloret.

2.7. Siguria në industrinë e prodhimit

Para së gjithash duhet të definojmë konceptin e sigurisë. Sipas një definicioni të reduktuar, siguria është mënjanimi i të gjitha aktiviteteve që synojnë (kanë për qëllim) të rrezikojnë personat (punëtorët) objektet apo hapësirën e caktuar. Duke marrë parasysh vlerat dhe të mirat e mbrojtura dallojmë këto lloje të sigurisë:

- Siguria personale
- Siguria kombëtare
- Siguria e hapësirës
- Siguria e të dhënave
- Siguria e komunikacionit
- Siguria ushtarake dhe
- Siguria e objekteve etj.

Kompanitë prodhuese duhet të ofrojnë vend të sigurve pune për punëdhënësit. Ka lloje të ndryshme të bizneseve të prodhimit. Një kompani apo biznes mund të prodhojë ushqim, mjete motorike, lodra, mobileje, tekstil, pajisje kompjuterike dhe plotë e plotë produkte të tjera. Megjithatë pa marrë parasysh produktin apo madhësinë e kompanisë punëdhënësi dhe ekipi menaxhues është përgjegjës për sigurinë e të gjithë punëtorëve. Shumë procese dhe aktivitete të llojllojshme dhe pajisje të ndryshme përdoren në industrinë e prodhimit prandaj edhe çështja e sigurisë është çështje me prioritet të lartë.

KAPITULLI 3 PLANIFIKIMET RRETH FAKTORËVE TË SIGURISË NË FABRIKAT PRODHUESE

Në mënyrë që të arrihet qëllimi dhe objektivi i këtij punimi, është e domosdoshme që shtjellimi i punimit të ndodh përmes aplikimit të metodave relevante hulumtuese. Për këtë arsye, qasje të ndryshme metodologjike do të jenë të zbatueshme në të gjithë punimin. Përveç kësaj, është thellësisht e rëndësishme që materialet dhe të dhënat e mbledhura, të analizuar dhe shqyrtuara të jenë në gjendje për të bërë konkluzione të arsyeshme.

Gjate gjithë punimit aplikohen burime parësore/primare dhe dytësore/sekondare. Ndër burimet sekondare përfshin të dhënat e mbledhura nga persona të tjerë, qoftë nga institute të ndryshme ose nga hulumtues tjerë. Burime sekondare të tilla, si të dhënat nga librat, raporte, statistikat, strategji, dhe burimet e internetit do të vlerësohen dhe analizohen në mënyrë kritike. Qëllimi i adoptimit të kësaj metodologjie është për të pasur koncept të qartë në lidhje me situatën aktuale të sigurisë në vendin e punës në Kosovë, në përgjithësi, dhe situatën aktuale të sigurisë në sektorin e prodhimit Kosovës në veçanti.

Hulumtimi të ndahet në dy metoda të cilat përdoren më së shumti, dhe këto janë metodat kualitative dhe kuantitative. Autorja konsideron se të dyja këto metoda janë të përshtatshme për të përmbushur qëllimin e këtij hulumtimi, dhe pasi kjo tezë do të hulumton rëndësinë, faktorët, karakteristikat, politikat dhe procedurat e sigurisë në vendin e punës së sektorit të prodhimit në Kosovë, dhe pasi metoda kualitative lejon krahasimin e të dhënave empirike të mbledhura nga burimet sekondare. Këto të dhëna janë të siguruar nga baza të ndryshme të dhënash duke filluar nga data bazat ekzistuese të ministrive, instituteve, agjencive dhe institucioneve relevante në Kosovë.

Ndërsa aplikimi i metodës kuantitative është i përshtatshëm pasi që është e strukturuar duke përdorur pyetësorë për arritjen e të dhënave. Pra të dhënat e marra në teren përmes pyetësorit do të shërbejnë për të vlerësuar sigurinë në vendin e punës në industrinë e prodhimit në Kosovë. Për këtë qëllim të dhënat primare do të mblidhen përmes pyetësorit nga disa prodhues lider në Kosovë si: KEK, Feronikeli, Sharrcem, Birra Peja, etj.

Pra, mbledhja e të dhënave bëhet përmes pyetësorit të drejtpërdrejtë. Pyetësi shpërndahet tek katër (4) biznese aktive të ndryshme të potencuar me lartë me rreth 20 të anketuar. Në pyetësorë u jepen disa opsione për të zgjedhur. Në disa pyetje ka vetëm një mundësi zgjedhje, ndërsa në disa raste tjera të anketuarit kanë mundësi të zgjedhin më shumë se në përgjigje. Të dhënat e pyetësorit pastaj përpunohen dhe prezantohen si në kapitullin e katërt. Pyetësi përmban 10 pyetje.

KAPITULLI 4 SIGURIMI I KUSHTEVE NË SIGURINË MAKSIMALE NË FABRIKA PRODHUESE TË MËDHA INDUSTRIALE NË KOSOVË

Për të kuptuar më mirë të situatë e sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës të sektorit të prodhimit në Kosovë, në këtë kapitull do të përmblihen të dhënat e nxjerra nga pyetësi që janë bërë me njerëz të pozitivë të ndryshme që janë në një farë mënyre ballafaqohen me çështjet e shëndetit dhe sigurisë në vendet e punës.

Situata do të shoqërohet gjithashtu me disa fotografi të marra nëpër vende të ndryshme të sektorit të prodhimit. Përmbledhjet e rezultateve të pyetësit janë rezultatet e pikëpamjeve subjektive të të anketuarve për çështjen e dhënë në çdo pyetje dhe përgjigjeve të tyre.

Gjatë zbatimit të pyetësit prej 10 pyetjesh, variabël e rëndësishme ka qenë edhe moshë, gjinia, profesioni, edukimi dhe të hyrat mujore. Duke filluar me moshën, nga gjithsej 20 anketues, 7 anketues apo 35% i kanë takuar grup moshës 18-30 vjeç, 7 anketues apo 35% të grup moshës 31-42 vjeç, 6 anketues apo 30% të grup moshës 43-60 vjeç dhe zero anketues apo 0% të grup moshës mbi 60 vjeç.




Figura 4.1 Grup moshat e të anketuarve

Në lidhje me gjininë e anketuesve pjesëmarrës në pyetësor është për tu theksuar fakti se një pjese e vogël e të punësuarve i takojnë gjinisë femërore me vetëm 20%.




Figura 4.2 Gjinia e të anketuarve

Respondentet e anketuar i takojnë profesioneve të ndryshme, dhe ndërë profesionet më të shpeshta të cilët janë listuar në pyetësorë paraqiten si në Tabelën 4.1 me poshtë. E rëndësishme të theksohet se megjithatë atë inxhinieret përbejnë numrin me të madhe të të anketuarave.

Tabela 4.1 Profesionet e të anketuarve

<i>Profesioni</i>	<i>Numri i përgjigjeve</i>
Ekonomist	3
Kontabilist/e	4
Punëtor	1
Inxhinier	7
Mekanik	2
Elektricitist	3

Niveli i edukimit të të anketuarve është relativisht i mirë, ku shumica e të anketuarve të paktën kanë ndjekur edukimin universitar. Por edhe një pjese e vogël e të anketuarve kanë edukimin e mesëm.




Figura 4.3 Niveli i edukimit të të anketuarve

Rezultatet e pyetjes së parë duket të jenë të zakonshme sepse të tilla janë nga natyra e punës. Çfarë duket të jetë e nxjerr e rëndësishme është se fare pak e shohin si problem pajisjen me makineri adekuate. Kjo në një fare mënyrë është tregues i mire se sektori i prodhimit është mjaft mire i pajisur me mjete të sigurisë dhe shëndetit në punë e të cilët janë të parapara edhe me ligjet e aplikueshme në Kosovë.




Figura 4.4 Aktivitet apo punimet më të rrezikshme në prodhim

Nga aktivitete që më së shumti paraqesin rreziqe në vendin e punës duket se problemet që paraqiten me makineri derisa sa janë duke i përdorur. Po ashtu puna gjatënatës po ashtu duket se konsiderohet mjaft e rrezikshme për faktin se gjasat që të paraqiten rreziqe të ndryshme ndaj tëpunësuaravejanë të mëdha, për shumë faturë të ndryshëm, siç pagjumësia, variabiliteti me i mangët etj.

Foto me poshtë tregon aspekte të rrezikut të lartëpër shkak tëgërmimeve dhe shpuarjeve.



Figura 4.5 Rreziku për shkak të gërmimeve dhe shpuarjeve

Foto e më poshtme tregon një rast të eksplodimit në Ferronikel, brenda hapësirave prodhuese për shkaqe të ndryshme por edhe për shkak të makinerisë së vjetruar dhe mungesës së pajisjeve apo makinerisë adekuate për punë.



Figura 4.6 Foto nga Ferronikeli




Figura 4.7 Aktivitet të cilat paraqiten me shumë aksidente serioze me lëndime



Figura 4.8 Bechtel-Enka,gërmimet e pa kontrolluara mund të rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve.




Figura 4.9 Bechtel-Enka punët e pa kontrolluara mund të rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve.

Në këtë Foto duket punëtori i varur në vinç dhe jeta e tij e rrezikuar skajshmërisht nga rënja nga lartësia shumë e madhe.

Pyetja e radhës ka të bëjë me lëndimet më të zakonshme nga aksidentet në vendin e punës. Duket se një pjesë e konsiderueshme e fajit është vetë faktori njeri për shkak të mungesës së vigjilencës së duhur derisa është në vendin e punës apo duke punuar, dhe kështu deklarohen 8 prej të anketuarve apo rreth 40% e tyre. Po ashtu lëndime të ndryshme të vogla, duket të jenë mjaft të zakonshme, si me thyerje këmbëve, krahavorit, thyerje apo prerjeje e gishtërinjve, gërvishtje të ndryshme, etj. Deklarimi i rreth 20% se humbja e jetës se punëtorit është po ashtu element shqetësues. Kjo duhet të ndodh kryesisht nëpunën gjatë natës, në mungesë së përqendrimit të mjaftueshëm në punë apo për shkak të kryerjeve të punëve në lartësi apo në ambiente të rrethuara me makineri të rëndë.




Figura 4.10 Lëndimet më të zakonshme në vendin e punës

Pyetja e radhës ka të bëjë me atë se si veprojnë kompanitë në praktik për të parandaluar paraqitjen e aksidenteve në të ardhmen, dhe masat që ata i marrin në këtë aspekt. Në lidhje me këtë, në Tabelën 4.2 paraqiten përgjigjet më të shpeshta të dhëna nga të anketuarit.

4. Si i zbatoni gjetjet nga aksidentet në punën tuaj të ardhshme? (dhe për rregulloret e brendshme të kompanisë tuaj për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve?)
Të gjitha aksidentet hetohen, analizohen, vlerësohen dhe veprohet varësisht nga gjetjet
Ne shkruajmë raportin dhe pastaj paraqesim të dhënat në takimet koordinuese dhe të përpqemi të japim një zgjidhje për të parandaluar ndodhjen e incidentit në të ardhmen
Është lëshuar një fletë udhëzimi, të gjithë punëtorët janë të familjarizuar me shkaqet efektet e aksidentit dhe shkaqet e aksidentit integrohen në standardet e brendshme të punës.
Aksidentet raportohen dhe vlerësohen. Nga vlerësimi rinxjerrën sugjerimet për përmirësimin e situatës në vendin e punës. Ne mbledhim shumë të dhëna nga aksidentet.
Në rastin e aksidentit të rëndë: ne e analizojmë atë, pastaj e sjellim në menaxhmentin e kompanisë ku ne sugjerojmë zgjidhje për këtë situatë dhe pastaj krijojmë një të standard / praktike të re dhe i zbatojmë sipas rregulloreve tona të brendshme të kompanisë. Ne gjithashtu bashkëpunojmë me kompani të tjera dhe ne ofrojmë analiza dhe analiza të tjera nga përvoja e aksidenteve dhe ne përpqemi të ndihmojmë njëri - tjetrin për të përmirësuar në fushën e sigurinë në punë.

Tabela 4.2 Zbatimi i gjetjeve nga aksidentet në punën e ardhshme

Pyetja e pestë adreson angazhimin dhe seriozitetin e punëdhënësve për të siguruar ambient të sigurtë dhe të shëndetshëm për punëtorët e tyre. Pasi që politika dhe procedura mund të konsiderohet si hapi i parë mbrojtëse për të punësuarit e tyre, edhe rezultatet e të anketuarve janë bukur pozitive në këtë aspekt. Vërehet se pjesa dërmuese e të anketuarve, 15 prej tyre apo rreth 75% për qind deklarohen se kanë marrë hapin e parë që parashihet edhe me ligje. Një pjesë e vogël janë në proces ose nuk kanë ndërmarrë asnjë mase për të siguruar ambient të përshtatshëm dhe të sigurtë për punë.




Figura 4.11 Politikat dhe procedurat për sigurinë dhe shëndetin në punë

Në lidhje me këtë pyetje si shembull ilustrues mund të shkëputemi pjese Kodi i sjelljes dhe etikes i KEK në lidhje me sigurinë dhe shëndetin. Nder të tjera KEK zotohet se, “KEK-u është i vetëdijshëm se shumë nga punëtorët e vet punojnë në një mjedis të vështirë dhe sfidues. Në këtë kontekst, KEK-u do të përmbushë kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji në fuqi të cilat kanë për qëllim sigurimin e një mjedisi të sigurt të punës për punëtorët.”¹⁰

Niveli i implementimit të legjislacionit në praktikë është adresuar dhe nxjerrë nga rezultati i pyetjes së gjashtë. Rezultati duket mjaft i ndarë, edhe pse shumica e konsiderojnë si implantimi të dobët me rreth 40% e tyre. Një pjesë e konsiderueshme e tyre me rreth 35% mendojnë se implantimi i masave të sigurisë në punë që dalin nga legjislacioni në fuqi, implementohet mirë.

¹⁰<http://kek-energy.com/kek/kodi-i-sjelljes-dhe-etikes/>




Figura 4.12 Implementimi i praktikave dhe legjistacionit në fuqi

Foto me poshtë tregon qendrëtrajtuese dedikuar trajnimit të punëtorëve në fushën elektrike. Kandidatët e orientuar në Lëmin e Elektrikes, së pari përfitojnë njohuri dhe shkathtësi në: bazat e elektrikes dhe elektronikës, masat mbrojtëse elektrike, teknikë të rregullimit, matje të madhësive jo elektrike - sensorët, elektronikë energjetike, ngasjeve elektrike, makinave sinkrone dhe asinkrone, komandimin e rrymave trefazore, menaxhimin e pikave matëse të energjisë, operimet në trafostacione dhe kabllot energjetike.



Figura 4.13 Qendra trajtuese dedikuar trajnimit të punëtorëve në fushën elektrike



Figura 4.14 Foto nga Sharr Cem Elez Han

Foto e mësipërme nga Sharr Cem mund të konsiderohet si shembull për implementimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në përgjithësi, dhe për tri fakte të sigurisë në veçanti. Duket se të gjithë punëtorët janë të pajisur me masa mbrojtëse adekuate si helmata, dhe rroba mbrojtëse. Në anën e majte qëndron një tabela e cila i përmban të gjitha shenjat e sigurisë që duhet të posedon një i punësuar para hyrjes në fushë punishte, dhe po ashtu mund të vërehen shkallet emergjente të cilat përdoren në raste emergjente. Në këtë respekt, Drejtori i përgjithshëm i Sharrcem-it, Emanuel Mitsou theksoi se **“siguria dhe shëndeti në punë në kompaninë e prodhimit të çimentos, është një kulturë që po dëshirojnë për punëtorët dhe kontraktorët, sepse është një industri e rëndë që punohet 24 orë në ditë. Ai tha se në këtë kompani kanë instaluar pajisje dhe makineri të sofistikuar me standard të larta për të pasur siguri të lartë në punë.”**¹¹

Përkundër kësaj, nganjëherë shënohen edhe aksidente të rënda deri me fatalitet, ku pikërisht në këtë hapësirë prodhimi, ku “një punëtorësh të nxjerrë i vdekur nga rrënojat, pas një konstrukt betoni është shembur”.¹²

¹¹<http://www.kosovapress.com/sq/biznes/sharrcem-shembull-i-shendetit-dhe-sigurise-ne-pune-90997/>

¹²Kallxo.com “NjeivdekurneSharrCem”, 2011, qasur nga <https://kallxo.com/gjnk/nje-i-vdekur-ne-sharr-cem/>

Pyetja e shtatëvlerëson ndikimin e sigurisë dhe shëndetit në pune. Ashtu edhe siç mund të pritët, shumica e të anketuarve vlerësojnë se është e rëndësishëm për të siguruar ambient për punëtorin i cili është i shëndetshëm dhe i sigurt për tëpunësuarit. Kjo sipas tyre ka ndikim dhe efekt pozitive në cilësinë e prodhimit, dhe kështu mendojnë hiq me pak se 80% e të anketuarve. Vetëm 3.15% e të anketuarve mendojnë se për të ngritur cilësinë e prodhimit faktorët e sigurisë dhe shëndetit në punë nuk luajnë rol pozitive dhe as të rëndësishëm.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se pa ambient të punës i cili do të ishte i sigurtë për të punësuarit, jo që nuk do të ketë prodhim cilësor por është esenciale për të siguruar ambient të sigurtë të punës, pa marr parasysh nëse do të ketë prodhim cilësor apo jo.

Po ashtu, në mungesa të sigurisë në punë, elementi i konkurrencës nuk mendohet të vihet në funksion. Pra, nuk bëhet fjalë tëhysh në radhën e konkurrencës duke mos i ofruar ambient të rehatshëm pune pasi që në fillim jenë disa vantash. Vetëm pasi të ofrohen kushtet e punës, mund të konsiderohet hyrja në radhën e konkurrencës në sektorin e prodhimit.




Figura 4.15 Ndikimi i ambientit në ngritjen e cilësisë së prodhimit

Pyetja në vijim siguron të nxjerrë rezultate nëse të punësuarit ndjekin apo trajnohen për çështje të sigurisë dhe shëndetit në vendin e tyre tëpunës. Në këtë aspekt duket se ende mbetet shumë për tu bërë, për arsye se shumica e të anketuarve deklarohen se nuk kanë pasur trajnime

duhur në dy vitet e fundit ose nuk kanë pasur asnjëherë një trajnim të tillë pavarësisht se është kërkesë ligjore që së paku një herë në brenda 2 viteve të kenë një trajnim.




Figura 4.16 Ndjekja e trajnimeve për sigurinë në punë



Figura 4.17 Foto nga trajnimi në KEK

Foto e mësipërme është realizuar në punëtorinë trajnuese në KEK në programin Mekanikë.

Kandidatët do të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi në: mekanikë themelore, operim me makina shpuese, operim me torno, operim me makinë frezuese, pneumatikë, elektropneumatikë,

hidraulikë, elektrohidraulikë, PLC, vullkanizim të shiritave transportues, operim me ekskavator, operim me makina të rënda etj.



Figura 4.18 Foto nga KEK-u trajnimi nga siguria në punë

Kandidatët e orientuar në Lëmin e Sigurisë në punë në Qendrën e trajnimit - KEK, do të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi në: Siguri industriale dhe mbrojtje nga zjarri dhe ofrimin e ndihmës së parë në vendin e punës deri të vijë ndihma e shpejtë ose pacienti të dërgohet në spital.

Ngajshëm, pyetja e radhës ka të bëjë me vlerësimin e rrezikut në ambiente të punës për elemente si zhurma e larte, mungesa e dritës së mjaftueshme, lagështi e tepërt apo të ngjashëm. Rezultatet e kësaj përgjigje tregojnë shumë për nivelin e implementimit të kërkesave ligjore për siguri dhe shëndet në punë në praktik. Rreth 65% e të anketuarve deklarohen se asnjëherë nuk kanë bërë vlerësim të rrezikut në ambientet e punës. Një numër kaq i vogël që kanë përmbushur këtë kërkesë ligjore tregon shumë seriozitetin e kompanive në lidhje me kujdesin e tyre për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve të tyre. Mbi të gjitha, kjo tregon se mbetet ende shumë punë për tu bërë edhe nga ana e autoriteteve përkatëse që kanë për obligim zbatimin e rregullave për sigurim e shëndetit dhe aspekteve tjera të sigurisë në vendet e punës.




Figura 4.19 Vlerësimi i rrezikut të ambientit të punës

A thua çfarë do të ishte rezultati i vlerësimit të rrezikut për shëndetin në këtë foto!!



Figura 4.20 Foto nga ndotja e ambientit në KEK

Sigurimi i shenjave treguese dhe vendosja e tyre nëpër vende të duhura nëpër vendet e punës është një element i rëndësishëm për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve. Kjo çështje adresohen në pyetjen e radhës. Dhe nga përgjigjet duket se të paktën shenjat e sigurisë në masë të

madhe janë vendosur në vendet e punës se tyre. Megjithatë, mungesa e trajnimeve adekuate vendosja e shenjave tregues të sigurisë, mund të kalojnë pa u vërejtur për rrëndësinë e tyre.




Figura 4.21 Vendosja e shenjave të sigurisë

Foto më poshtë tregon një ilustrim të shenjave që duhet të jenë nëpër vende të caktuar të ambientit të punës.




Figura 4.22 Foto disa nga shenjat e sigurisë.

Ndërsa kjo foto në fushën e saldimit, tregon se si duhet të pajisen të punësuarit më mjete mbrojtëse për mbrojtjen e syve dhe fytyrës.



Figura 4.23 Foto nga KEK-u pajisjet për saldimit.

KAPITULI 5 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Si përfundim, siguria dhe shëndeti në punë vazhdojnë të mbesin sfidë që nga periudha e pasluftës. Edhe pse korniza ligjore në fuqi ofron një bazë të mirë, duhet që kjo të përmirësohet edhe më tutje. Duke marrë parasysh se pa implementim të legjislacionit, ky i fundit mbetet i padobishëm, është qenësore që Inspektorati i Punës të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore, si nga punëdhënësit dhe punëmarrësit. Si një temë shumë e gjerë dhe me shumë hapësirë për përmirësim, siguria dhe shëndeti në punë duhet të adresohet me seriozitet dhe në mënyrë të shpejtë.

I padiskutueshëm mbetet fakti se siguria dhe shëndeti në punë është element shumë i rëndësishëm për kompanitë e sektorit të prodhimit, veçanërisht, tek kompanitë e mëdha ndikon në masë të madhe në ngritjen e prodhimit të tyre. Kjo mund të vërehet në pyetjet nga pyetësi ku shumica e të anketuarve theksojnë se elementi i sigurisë dhe shëndetit është esencial për të qenë konkurrent në treg. Në mungesë të strategjisë konkurruese në mesin e sëlilës duhet të jenë edhe çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, një strategji është e mangët dhe gjasat janë që të jenë jetëshkurtër dhe jo konkurruese në treg.

Më tutje, kompanitë duhet të vetëdijesohen dhe të përmbushin dispozitat e kërkuara me anë të ligjit. Derisa jemi tek vetëdijesimi, kompanitë duhet edhe të punojnë në vetëdijesim të punëtorëve për sigurinë dhe shëndetin në punë. Në këtë aspekt, këto të fundit duhet të përdorin masa ndëshkuese për ata punëtorë të cilët nuk bashkëpunojnë.

Është vërejtur se aspekti i të pasurit një program të shkruar ku do të shërbente si linja e parë mbrojtëse për të punësuarit është ende një çështje që kërkon me shume përkushtim nga punëdhënësit. Rezultatet e pyetësit tregojnë se pjesa e programit të shkruar si dhe ofrimi i trajnimeve adekuate ende mbetet për tu bërë shume pasi që vetëm 45% e të anketuarve theksojnë se kanë ndjekur trajnime relevante për siguri dhe shëndet në punë.

Hiq me mirë nuk qëndron fakti i kërkesës ligjore për personat juridik për të bërë vlerësimin e rrezikut në ambientet e punës. Sipas rezultatit të pyetësit ky element duket se është ende në hapat e parë pasi që mbi 65% e të anketuarve deklarohen se asnjëherë nuk e kanë

bërënjëvlerësim të rrezikut tëtillë. Pra, edhe pse kemi njëkërkese ligjore disa vjeçare, nga ana praktike nuk kemi ndonjë seriozitet në praktike.

Është e rëndësishme të theksohet sipas rezultateve të pyetje së dytë, se rreziqet më të larta në punë janë konsideruar puna gjatë natës, çështjet teknike të makinerisë jo adekuate, dhe trajnimet adekuate. Duke konstatuar se këto janë rreziqet më të lartë që paraqiten tek punëtori, është e rrugës që edhe të propozohen masa të shtuar të sigurisë përball këtyre rreziqeve, qoftë duke menaxhuar apo ngritur numrin e stafit në mënyrë që të ju mundësohet pushime më të shpeshta me intervale kohore, apo duke u pajisur me makineri me adekuate dhe të avancuar.

Literatura:

1. BADRI, Adel, André GBODOSSOU a Sylvie NADEAU.
Occupational health and safety risks: Towards the integration into project management.
Safety Science. 2012, vol. 50, no. 2, s. 190-198. ISSN 0925-7535.
2. Directive 2009/104/EC –use of work equipment
3. Directive 89/654/EEC –work place requirements
4. Directive 89/656/EEC –use of personal protective equipment
5. Directive 92/58/EEC –safety and/or health signs
6. Directive 99/92/EC –risks from explosive atmospheres
7. http://www.partneretsocial.org/uploads/files/2014/August/21/Broshura_e_Ligjit_pir_Sigurini_dhe_Shendetin_ni_Puni1408609958.pdf
8. Ligji (Nr.04/L-012) për Mbrojtje nga Zjarri
9. Ligji Nr. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË ne Kosovë.
10. M.sc. Hysen Hysenaj, Mbrojtja në punë dhe mbrojtje nga zjarri- Prishtinë 2014
11. Mustaf Ahmeti: Mbrojtja në punë dhe përpunimi i metaleve- Prishtinë 2014
12. Nida Krasniqi, Analizë e shkurtër mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, qasur nga
http://www.ngo-pen.com/wp-content/uploads/2017/07/Siguria-dhe-shendeti-ne-pune_WEB.pdf
13. Qendra për Politika dhe Avokim, “Të drejtat e punëtorëve (korniza ligjore, siguria në punë, dhe mekanizmat zbatues)”, Qershor 2014.
14. Rregulloret e Nxjerrura nga Ministria e Punës dhe Mireqenies Sociale si rregulloret e MPMS nr.03/2014, Nr.05/2014, Nr.02/2014, Nr.04/2016 dhe rregulloret tjera relevante të sigurisë në vendin e punës.
15. Toole, M. (2002). "The relationship between employees' perceptions of safety and organisational culture." *Journal of Safety Research*(33), 231–243.
16. Ward, Peter T., and Rebecca Duray. "Manufacturing strategy in context: environment, competitive strategy and manufacturing strategy." *Journal of operations management* 18, no. 2 (2000): 123-138.
17. Wilson, J. M., Jr., and Koehn, E. (2000). "Safety management: problem seen countered and recommended solutions." *Journal of Construction Engineering and Management*,

- 126(1).
18. *YIN, Robert K. Casestudyresearch: designandmethods. Fifthedition. LosAngeles: SAGE, 2014. ISBN 978-1-4522-4256-9.*
 19. Young, A., and Kielkiewicz-Young, A. (2001). "Sustainable Supply Network Management." *Corporate Environmental Strategy*, 8(3), 260.
 20. Rregullorja Nr. 03/2014 për Mënyrën e Përgatitjes së Dokumentit për Vlerësimin e Riskut
 21. Rregullorja Nr. 04/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës
 22. Rregullorja Nr. 05/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Përdorimin e Pajisjeve të Punës në Vendin e Punës.
 23. Burim Zogu, Punim Masteri. 2016
 24. (European College of Kosovo, pjese nga materiali i trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, 2019).

Me rastin e diplomimit në studimet postdiplomike në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, falënderoj familjen për përkrahjen e vazhdueshme gjatë studimeve dhe të gjithë ata që kontribuan në arritjen e sukseseve të mia. Në veçanti falënderoj mentorin Prof. dr. Ali Muriqin për sugjerimet e dhëna gjatë përgatitjes së punimit. Poashtu, për ndihmesë të konsiderueshme gjatë punës në këtë diplomë e falënderoj gjithashtu kryetarin e komisionit Akad. Prof. dr. Fejzullah Krasniqin si dhe anëtarin e komisionit Prof. asc. Rexhep Selimaj. Me rastin e diplomimit në studimet postdiplomike në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, falënderoj familjen për përkrahjen e vazhdueshme gjatë studimeve dhe të gjithë ata që kontribuan në arritjen e sukseseve të mia. Në veçanti falënderoj mentorin Prof. dr. Ali Muriqin për sugjerimet e dhëna gjatë përgatitjes së punimit. Poashtu, për ndihmesë të konsiderueshme gjatë punës në këtë diplomë e falënderoj gjithashtu kryetarin e komisionit Akad. Prof. dr. Fejzullah Krasniqin si dhe anëtarin e komisionit Prof. asc. Rexhep Selimaj.

Shtojcë: Pyetëtori

Tema : Vlerësimi i sigurisë në punë në industrinë prodhuese në Kosovë

Qëllimi i këtij pyetëtori është që të plotësoj të dhëna në punimin e temës së masterit në fakultetin të Inxhinierisë Mekanike – Universiteti i Prishtinës

Ju siguroj së të gjitha të dhënat në pyetësorë mbesin konfidenciale.

Emri Mbiemri¹³:

Mosha:

Gjinia:

Profesioni:

Edukimi:

Duhet të plotësohen / selektohen të gjitha pyetjet në vijim:

1. Cilat janë aktivitetet apo punimet më të rrezikshme në sektorin e prodhimit?

- a. mungesa e pajisjeve adekuate
- b. Puna rreth makinerisë së ndryshme
- c. Punime tokësore në gërmime
- d. Puna në lartësi

2. Cilat janë aktivitetet që paraqiten më shumë aksidente serioze me lëndime?

- a. Çështje teknike me makineri
- b. Bie nga lartësi të vogla apo gjësendeve

¹³Opsionale

- c. Puna gjatë natës

3. Cilat janë lëndimet më të zakonshme në vendin e punës në sektorin e prodhimitarisë?

- a. Mos përqendrimi në punë
- b. Lëndime të vogla etj.
- c. Aksidente me fatalitet

4. Si i zbatoni gjetjet nga aksidentet në punën tuaj të ardhshme? (dhe për rregulloret e brendshme të kompanisë tuaj për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve?)

5. A ka kompania juaj politika dhe procedura për sigurinë dhe shëndetin në punë?

- Po
- Jo
- Në proces

6. Deri në çfarë mase impletohen praktikat dhe legjislacioni në fuqi lidhur me sigurinë në vendin e punës në sektorin e prodhimit në Kosovë?

- a. Shumë i mirë
- b. I mirë
- c. I dobët
- d. Nuk implementimet fare

7. A ndikon pozitivisht ofrimi i një ambienti të sigurtë në vendin e punës në ngritjen e cilësisë së prodhimit?

- a. Po
- b. Jo
- c. Ska rendësi

8. Në dy vitet e fundit a keni ndjekur trajnim për sigurinë dhe shëndetin në punë?

- a. Po
- b. Jo
- c. Asnjëherë

9. Në tri vitet e fundit a është bërë vlerësimi i rrezikut të ambientit të punës

Falënderim

Me rastin e diplomimit në studimet postdiplomike në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, falënderoj familjen për përkrahjen e vazhdueshme gjatë studimeve dhe të gjithë ata që kontribuan në arritjen e sukseseve të mia. Në veçanti falënderoj mentorin Prof. dr. Agron Pajaziti për sugjerimet e dhëna gjatë përgatitjes së punimit. Poashtu, për ndihmesë të konsiderueshme gjatë punës në këtë diplomë e falënderoj gjithashtu kryetarin e komisionit Prof.dr. Hysni Osmani si dhe anëtarin e komisionit Prof.sc. Ali Muriqi

Aferdita Kryeziu